



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 18.8.2023, me fillim në ora 10:15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **zt. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin, **zt. Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P- 02320-0, zona kadastrale Rahovec, me pronën private P- 02240-1, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P- 05537-1, zona kadastrale Rahovec, me pronën private P-05539-0, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P- 01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P- 00050-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P- 01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P-01987-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronave publike P-01313-1, P-01313-2, P-01313-4, P-01313-5, zona kadastrale Rahovec, me pronën private, P-01313-3, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P- 01015-1, zona kadastrale Xërxë, me pronën private P-01015-12, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
8. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansamblit të Komunës së Rahovecit;
9. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali 2023-2025;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, fillimisht do t'ju prezantoj edhe një pikë shtesë që ka ardhur nga Drejtoria e Financave: **Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA 2022.** Me lejen tuaj kërkoj ta vendosim në rendi dite, kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Atëherë unanimisht edhe kjo pikë vendoset në rendi dite.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, nënkryetar, të nderuar drejtorë, kolegë të KPF-së. Me ardhjen e kryesuesit të ri, menjëherë ka filluar të ndryshojë funksionimi normal i asamblesë komunale. Pika e dytë e rendit të ditës, ka kaluar në pikën e dhjetë të rendit të ditës! Diskutimet e asambleistëve, pyetjet dhe përgjigjet ka qenë pikë e dytë dhe ka kaluar, është bërë pikë e dhjetë. Kjo më shumë po tingëllon si ngulfatje e diskutimit, sesa demokracisë së brendshme. Kur e keni marrë mandantin ke premtu ndyshe, tani vepron ndryshe. Kërkoj që pika e dytë e rendit të ditës të jetë pyetjet dhe përgjigjet e asambleistëve.

Kryesuesi – I nderuar zt. Krasniqi, e keni ngatërruar rendin e ditës së KPF-së, me atë të mbledhjes së rregullt të kuvendit. A ka edhe dikush tjetër prej anëtarëve ndonjë diskutim rreth pikave të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë e kalojmë në votim, kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesues – A ka dikush prej anëtarëve ndonjë vërejtje apo diskutim rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, miratohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P-02320-0, zona kadastrale Rahovec, me pronën private, P- 02240-1, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së, kërkojmë një përmirësim nga sekretariati, në rendi dite e kemi përmirësuar, bëhet fjalë për këtë pikë për këmbim me pronat e institucionit qendror, jo të institucionit privat. Bëhet fjalë për parcelën me nr. 2320-0, zona kadastrale Rahovec (Maja e Shkodranit, 2.5 ha). Ka shumë kërksa nga personat fizik dhe juridik që ta marrin këtë sipërfaqe për ta zhvilluar agro turizmin dhe punët tjera. Në mbledhjen e kuvendit do të kujdesemi që për secilën parcelë ta paraqesim me ortofoto. Po e marrim këtë parcelë të Maja e Shkodranit dhe Agjencionit Pyjor ia japim pjesën e barasvlefshme e cila gjendet konkretisht afër pishinës “Shala”. Kërkojmë nga ju që të marrim vendim-pëlqim për këmbim.

Burim Krasniqi – Faleminderit drejtor për shpjegimin! Është fakt që këmbimet janë të ngjashme dhe asambleja iu jep të drejtën që procedurat të zhvillohet tutje. A ka pasur komision që është bërë ky vlerësim nga komuna dhe a ka mundësi që në seancën e rregullt të jetë edhe materiali i vlerësimit të komisionit profesional të parcelave?

Afrim Oruqi – Po, kryetari ka marrë vendim dhe janë formuar gjashtë komisione ashtu siç kërkohet sipas ligjit. Komisionet janë duket e bërë punën e vet dhe para seancës së kuvendit komunal do ta përgatisin një raport me arsyeshmëritë që pronat janë të barasvlefshme.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P-05537-1, zona kadastrale Rahovec, me pronën private P-05539-0, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për parcelat që janë në zonën kadastrale në Rahovec, konkretisht pompa “Shell”. Kërkojmë prej juve që të marrim pëlqim për këmbim. Bëhet fjalë për një ari (100m²) dhe në bashkëbisedim me pronarin e kësaj parcele jemi dakorduar që rruga aty që është e kalueshme ta bëjmë rrugë publike për interes të përgjithshëm dhe në kompenzim t'i japim të njëjtën sipërfaqe e cila është në kufij me pronën private.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, të nderuar anëtarë të komitetit. Drejtor, a do të këmbëhet sipërfaqja e njëjtë e parcelës, apo është hapësirë më e madhe e sipërfaqes që do t'jepet personit privat?

Afrim Oruqi – Edhe ligji e kërkon kështu! Një prej kritereve është që të marrim pëlqim për këmbim dhe dy parcelat duhet të jenë në kufij me njëra tjetrën. Bëhet fjalë për dy sipërfaqe të njëjta 100 m².

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P-01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P- 00050-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për dy zona, për një zonë në Opterushë dhe një në Retijë. Konkretisht në Zonën Ekonomike dhe është kusht i ligjeve në fuqi që të ketë qasje aty prej rrugëve dytësore, jo në rrugë kryesore dhe është fat i mirë që kemi mundësi dhe kërkojmë pëlqim prej juve që të këmbejmë pronën e Agjencionit Pyjor me pronë të komunës. Gjiashtu është mirë të ceket edhe në procesverbal sepse sipas ligjit kërkohet që parcelat të jenë në kufij me njëra tjetrën, por ka qenë e pamundur të gjenden parcela të lira komunale në Opterushë. Gjatë kërkesës kemi hasur në një parcelë e cila është e komunës në zonën kadastrale në Retijë. Bëhet fjalë për 1ha e 20 ari, do t'i merren Agjencionit Pyjor që është në kufij në Zonën Ekonomike në Opterushë, dhe e njëjta sipërfaqe do t'i jepet nën menaxhim Agjencionit Pyjor në zonën kadastrale në Retijë, me qëllimin e vetëm që të implementohet projekti i cili ka rëndësi të madhe për Komunën e Rahovecit.

Defrim Kafexhiu – Drejtor, a ka pasë ndonjë problem gjatë implementimit të projektit për Zonën Ekonomike që po ndërtohet atje. Përndryshe i njëjti ligj ka funksionuar edhe më herët para fillimit të rregullimit të Zonës Ekonomike. D.m.th është ditur qysh më herët që kyqja duhet të bëhet prej rrugës dytësore! Pse tani po e kalojmë në kuvend këmbimin e pronës në mes komunës dhe agjencionit për t'i krijuar qasje Zonës Ekonomike prej rrugës dytësore, përderisa kjo ka mundur të ndodhte para fillimit të implementimit të Zonës Ekonomike, apo ka pasur ndonjë problem aty, që tani e kemi obligim si komunë të krijojmë zgjidhje?

Afrim Oruqi – Zona Ekonomike ka filluar të ideohet pas luftës në 2003 dhe është fat i mirë që po realizohet në mandatin tonë dhe prona ka kaluar në emër të Komunës së Rahovecit. Është fat gjithashtu i mirë që këto dy parcela janë prona të shtetit, janë në Komunë të Rahovecit dhe menaxhohen prej dy agjencioneve të ndryshme. Nuk kemi pasur problem me agjencione, përkundrazi, jemi në dakordim të plotë. Që mos a ngarkojmë rrugën kryesore Rahovec – Suharekë, po e bëjmë qasjen në rrugën Rahovec – Opterushë.

Defrim Kafexhiu – Edhe një koment, jo replikë! Nuk dua të diskutoj më shumë për këtë qështje edhe pse unë jam “për”. Një përkujtim për drejtorin! Kur the që projekti po realizohet në mandatin e juaj, është mandati i tretë që jeni duke e udhëhequr dhe Zona Ekonomike ende nuk është “kërkah”!

Burim Krasniqi – Drejtor, Zona Ekonomike është një projekt që financohet bashkë prej insitucioneve qëndrore dhe komunale. Te çështja e menaxhimit, a do ta ketë institucioni qëndror apo komuna, nuk e kam informatën e plotë. A ka ekzistuar mundësia që prona qëndrore, të kalojë në pronë komunale si pjesë të Zonës Ekonomike pa këmbim si pjesë e bashkëfinancimit, apo jemi të obliguar patjetër ta këmbejmë.

Afrim Oruqi – Është e vetmja mundësi që të bëjmë këmbim sipas ligjit. Më herët këto punë janë kryer nga Sektori i Pronës dhe fatkeqësisht shumë drejtorë janë me aktakuza nëpër prokurori dhe është fat i mirë që ne e kemi këtu në kuvend sepse sipas ligjit nuk ka mundësi tjetër ligjore.

Burim Krasniqi – Më keqkuptove! Nuk po të them unë, se pse e kemi këtu në asamble, por, a ka qenë e mundur që asambleja me vendim t'i drejtohet insitucioneve qëndrore, që ajo pronë të kalojë në pronë komunale pa këmbim, meqenëse është pronë publike!

Afrim Oruqi – Është kërkesë e arsyeshme, por ligjërisht e pamundur. Është e pamundur të marrim pronësi pa vendim dhe pa këmbim!

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P-01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qëndror P-01987-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për dy zona të njëjta, në Opterushë dhe Retijë. Në këtë rast bëhet fjalë për pronën e cila menaxhohet prej Agjencionit të Ujërave, 6 ari e 50m². I jipet Agjencionit të ujërave në të njëjtën zonë që është pronë e komunës, sikurse pika paraprake në Retijë në sipërfaqe të njëjtë. Pra, Agjencionit të Ujërave i merren 6 ari e gjysmë, këtu në kufij me Zonën Ekonomike dhe i jipet në Retijë prej të njëjtës parcelë që është pronë komunale.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronave publike, P-01313-1, P-01313-2, P-01313-4, P-01313-5, zona kadastrale Rahovec, me pronën private, P-01313-3, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec, te Sheshi Qëndror i qytetit. Bëhet fjalë për një pronë private që ka tre pronarë. Kemi provuar të bëjmë parcelizimin e kësaj parcele në seancë të kuvendit, mirëpo kjo e drejtë rregullohet vetëm me Hartë Zonale dhe është kthyer e kundërligjshme. Tani jemi duke provuar ta këmbejmë dhe ta arrijmë qëllimin që mos të pengojmë në implementimin e projektit të sheshit. 4 ari e 46m², i mirret pronës private dhe parcelave e cekura në vendim (4 parcela) iu marrim pjesën P-1313-5, 128 m². P- 1313-4, 71 m². P- 1313-2, 137 m². P-1313-1, 110 m², të gjitha këto bashkë prona të komunës e përbëjnë totalin e përgjithshëm prej 4 ari e 46m².

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike, P-01015-1, zona kadastrale Xërxë, me pronën private P-01015-12, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Xërxë. Këmbimi ndërmjet pronës private dhe pronës komunale, është një rrugë e cila është e kalueshme dhe e kubëzuar pas vitit 2014. Për shkaqe të arsyeshme dhe të drejta nga pala, rruga që është shtruar nga Komuna e Rahovecit ka prekur këtë sipërfaqe të pronës private, në të njëjtën zonë kemi rregulluar edhe disa parcela të tjera, për shkak se palët po bëjnë padi ndaj kuvendit komunal dhe me gjasë e fitojnë rastin. Për t'i ikur këtyre shpenzimeve tjera të avokaturës dhe përmbaruesit, po provojmë ta rregullojmë edhe këtë problem në kuvend. Pra, bëhet këmbimi ndërmjet pronës private dhe pronës komunale. (1 ari e 34m²) i mirret pronës private e cila është në posedim të Sulejman Hamdi Kryeziut dhe i jipet e njëjta sipërfaqe që është në pronësi komunale, me qëllimin e vetëm të zgjerimit të rrugës publike.

Leonard Morina - Faleminderit kryesues! Përhëndetje nënkryetar, drejtorë, të gjithë të pranishmit. Meqenëse kjo rrugë ka qenë e shtruar me kubëza në vitin 2014, si ka pasur guxim komuna ta shtrojë pronën private dhe a ka reaguar personi privat nga ky rast?

Afrim Oruqi – Shumica e rrugëve publike si në qyteta ashtu edhe në fshatra, fatkeqësisht sipas gjendjes kadastrale janë të ngushta dhe kur këto rrugë kubëzohen, asfaltohet me pëlqimin e palës mund të ketë edhe zgjerim në parcela private. Në atë kohë nuk ka pasur reagim, deri tani që ka filluar kërkesa për këmbim. Në çoftëse kërkesat refuzohen, ata drejtohen në gjykatë dhe fitohet e drejta e këmbimit apo shpronësimit.

Burim Krasniqi – Drejtor, në cilin vend është në Xërxë, te shkolla, aty ku e ka shtëpinë Suleman Kryeziu apo është fshat afër qerdes?

Afrim Oruqi – Saktësisht është në anën e djathtë të rrugës Rahovec – Prizren!

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansambllit të Komunës së Rahovecit;

Afrim Dina – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Para jush keni Draft – Statutin e Ansambllit të Komunës së Rahovecit. Me datë 31 mars, në mbledhjen e kuvendit është aprovuar miratimi që të fillohet me punimet për statutin e ansambllit të Komunës së Rahovecit. Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, paragrafi 2 i ligjit Nr.04/164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve, themelohet statuti i ansambllit komunal. Me caktimin e grupit punues nga kryetari i komunës për hartimin e statutit, me datë 04.04.2023 DKRS-ja ka hartuar draft-statutin e Ansambllit të Komunës së Rahovecit. Grupi punues ka mbajtur takime të vazhdueshme. Me datë 03.07.2023 në sallën e kuvendit komunal është mbajtur konsultim publik me qytetarë, ku janë marrë komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve. Draft-statuti i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore, nga 20.06.2023 – 20.07.2023 ka qenë në konsultim publik për të gjithë qytetarët të cilët kanë pasur mundësi edhe të japin komente dhe sugjerime. Ansambli si objekt veprimtarie ka zhvillimin e artit skenik, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe kultivimin e vlerave kombëtare.

Burim Krasniqi – Faleminderit drejtor për prezantimin. E përmende që keni mbajtur takime me qytetarët. Qytetarët mund të jenë jo fort të familjarizuar me funksionimin e një ansambli. Me qëllim të krijimi të mundësisë sa më të mirë për të gjithë, konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet për seancën e radhës. Të takoheni me shoqëritë kulturo-artistike që operojnë në Komunën e Rahovecit ose me shkollën e muzikës në Rahovec dhe t'i merrni komentet, në seancë të vinë rekomandimet që kanë dalur nga ky takim. Rekomandoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

Afrim Dina – Takimi me qytetarë ka qenë konsultim publik me datë 03.07.2023. Kanë qenë të ftuar të gjitha OJQ-të, në takim ka pasur njerëz profesionistë të muzikës dhe të artit. Në takim janë marrur komentet dhe sugjerimet, i kemi të regjistruara në procesverbal.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim propozimin e Burim Krasniqit, kush është “për”?... Atëherë me shumicë votash aprovohet propozimi i Burim Krasniqit, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës.

9. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali 2023-2025;

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së. Më lejoni që sot para jush të prezantoj Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, 2023-2025, e cila është e derivuar nga strategjia e planit të veprimit për përfshirjen e këtyre dy komuniteteve 2022-2026. Kjo strategji ka për qëllim përfshirjen e komunitetit Rom dhe Ashkali, pa komunitetin Egjiptian, sepse politikisht ky komunitet ka kërkuar të largohet nga një strategji e tillë. Gjatë hartimit janë konsumuar të gjitha mundësitë ligjore që i kemi pasur për obligim. Ka kaluar në tri faza, faza 1 – analizimi i situatës së përgjithshme, faza 2 – analizimi i dokumenteve strategjike në fuqi dhe faza 3 - konsultimet. Në total, kostoja e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe punësimit është 99.220€. Synimet janë që 80% e mjeteve mendohet të realizohen me donatorë, pjesa tjetër nga fondi që ka Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me drejtoritë e ndryshme në komunë.

Burim Krasniqi – Faleminderit prezentuesin! Shqetësuese është kur thuhet që komuniteti Egjiptian kanë kërkuar të largohet për arsye politike. Nuk mund të jetë strategji e integritetit të komuniteteve në qoftëse një komunitet përjashtohet. Pse ata nuk kanë dashtë të jetë të përfshirë në strategji? Kërkoj arsyetim për këtë dhe të ulen përbashkëbisedim që strategjia të jetë gjithëpërfshirëse për komunitetet.

Lendrit Qeli – Faleminderit zt. Krasniqi! Sa për informatë, planet e veprimit derivojnë nga strategjitë që krijohen nga qeveria e Republikës së Kosovës. Qeveria në bashkëpunim me tre deputetë nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, janë dakorduar që të jetë në këtë nivel. Pra, niveli qendror e krijon strategjinë, kuvendet komunale obligohen t'i miratojnë planet e veprimit. Ne i kemi dhënë vërejtjet tona, sepse po flasim për një komunitet që në Komunën e Rahovecit janë mbi 200 qytetarë dhe padyshim që ne nuk do t'i përjashtojmë prej aktiviteteve, por si dokument është kërkuar të jetë i tillë.

Burim Krasniqi – Strategjia mbi bazën e së cilës po bëhet plani i veprimit, a e përfshinë komunitetin Egjiptian aty?

Lendrit Qeli – Kjo strategji, jo!

Kryesuesi – Faleminderit zt. Qeli ! A kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë e kalojmë këtë pikë në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

10. Plan i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA, 2022.

Afrim Limani – Faleminderit kryesues! Siç e dini edhe ju, auditimi i pasqyrave financiare për Komunën e Rahovecit për 2022 ka rezultuar me 9 rekomandime. Prej tyre, 5 janë të përsëritura dhe 4 rekomandime janë të reja. Mbi bazën e kësaj, si qeveri komunale e kemi formuar një komision për zbatimin e rekomandimeve në përbërje prej 9 anëtarëve. Një takim e kemi zhvilluar dhe raportin e kemi dërguar me kohë. Shpresoj që këto rekomandime deri në fund të vitit fiskal, 80% do të jenë të zbatueshme.

11. Të ndryshme;

Burim Krasniqi – E kam një pyetje për Drejtorin e Kadastrës! Drejtor, e di që jeni mirë të informuar për rastin e Veli Krasniqit në Xërxë. Bëhet fjalë te rr.” Ganimete Tërbeshi” e cila ka qenë shumë e ngushtë dhe në kohën kur Afrim Dina ka qenë kryesues është bërë shpronësimi i një parcele, që i ka mundësuar shkubëzimin e rrugës. Megjithatë në këtë procese është e lënë një parcelë, pronë private rreth 70 cm e gjërë dhe 80m e gjatë, e cila në atë kohë nuk është këmbyer. Kjo parcelë i përfshinë disa parcela para shtëpisë dhe në një far forme i pamundëson çasjen në rrugë, personave që i kanë shtëpitë aty. E di që ka kërkesë, më intereson a ka zhvilluar komuna procedura dhe pronari (nëse nuk gaboj, familja Sinani) e ka një hapësirë publike para shtëpisë aty dhe ekziston një mundësi e lehtë për zgjidhje dhe eventualisht të evitohen mosmarrëveshjet. Kërkoj mirëkuptim që në seancat e radhës të bëhet këmbimi.

Afrim Oruqi – Faleminderit! Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Xërxë. Një rrugë private në atë zonë e kemi këmbyer në kuvend, sipërfaqen e njejtë ia kemi dhënë para shtëpisë dhe e kemi hapë rrugën publike. Kur kemi

dalë në terren me gjeodet për incizim për këmbim, aty ka ndërtim (është një mur i betonit me dyer). Veli Krasniqi kur e ka bërë ndërtimin e murit e ka prekë pak pronën private në atë gjerësi 50-80cm dhe në atë gjatësi 80m-100m dhe nuk kemi guxuar ta këmbejmë parcelën private sepse i njëjti pronar që tani ka kërkesë për këmbim, ka rezultuar uzurpator i pronës komunale. Muri dhe dera i ka mbetur në pronë komunale sepse atë pronë e kemi bërë rrugë publike. Kërkesë me shkrim për kuvend, prej palës ende nuk ka! Përndryshe nëse ka kërkesë, brenda afatit i përgjigjem.

Burim Krasniqi – Drejtor, ndoshta është fakt që muri është në atë parcelë që në momentin e këmbimit kalon uzurpues, por është një fakt i dytë që kemi plot mure të trashëguara para lufës që janë uzurpime. Në një far forme, nuk mund të bëjmë “standart të dyfishtë”. Në momenti që komuna merr vendim që të lirohet parcelat e uzurpuara, i kërkon ta rrëzojë murin. Fakt është që aty mund të ketë tensione dhe kur ai iu ka drejtuar komunës do të ishte e udhës që ta orientoni që t’i bëjë kërkesë asamblesë komunale, vetëm e vetëm që mos të kemi situatë konflikti në mes dy familjeve. Kërkoj që t’i rekomandoni personit që t’i fillojë procedurat përmes asamblesë komunale.

Afrim Oruqi – Pasi bëhet fjalë për pronë private dhe zakonisht këto konteste sipas ligjit zgjidhen në konteste gjyqësore. Sipas ligjit edhe në këtë vit edhe në vitin e ardhshëm nuk kemi më kod që i vendosim mjetet për shpronësim, d.m.th nuk kemi të drejtë sepse kjo tani rregullohet me projekt dhe ne nuk kemi projekt si komunë. Në moment kur përfundon kontesti gjyqësor, me një kërkesë të palës e vetmja mundësi na mbetet ta shqyrtojmë këmbimin.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! Drejtoresha e Inspektoriatit nuk qenka këtu. E pata një kërkesë apo pyetje, që bujqit apo fermerët që po i plasojnë produktet e tyre ushqimore në treg gjatë kësaj sezone, nuk besoj që është e arsyeshme që mos t’iu lejohej shitja në mënyrë ambulante. Nuk besoj që ka diçka të keqe, përderisa ka hapësirë të mjaftueshme dhe nuk bëhet bllokimi i trotuarëve. Njëkohësisht, Komuna e Rahovecit në momentin kur i largon shitësit nga vendet e shitjes, si arsyetim e ka bllokimin e trotuarëve, gjë që nuk është e arsyeshme. Në punë të tjera, Drejtoria e Inspekcionit ankohet që nuk ka resurse njerëzore të mjaftueshme për mbikëqyrjen e punëve tjera, urbanizmi kurrë nuk ka qenë më keq dhe po arsyetoheni që nuk keni inspektorë të mjaftueshëm, e bujqit po shkoni e p’i largoni. Inspektorët mund të merrem me punë më të mençur, t’i lënë bujqit të shesin përderisa e kanë sezonën.

Nënkryetari – Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, nëse mendohet të bëhet politikë me bujqit sepse kështu kuptohet kjo situatë. Shitja ambulante është e ndaluar me një rregullore komunale dhe në vende të caktuara mund t’i shesin produktet e tyre. Bllokimi i trotuarëve, p.sh. në qendër të qytetit, nëse është sipas jush në rregull, atëherë sipas institucionit nuk është! Do të vazhdojmë t’i zbatojmë në përpikmëri politikat komunale.

Defrim Kafexhiu – Nënkryetar, e di që shitja ambulante është e ndaluar, sikurse që është e ndaluar edhe ndërtimi pa leje. Në Komunën e Rahovecit, ndërtimet pa leje janë duke dalur së “këpurdha”, ndërsa inspektorët kalojnë afër dhe janë duke i lejuar ndërtimet e ndryshme, prej shtëpive të banimit e deri te ndërtesat. Inspektorët është mirë të merren me këtë çështje sesa me shitësit ambulantiv të produkteve bujqësore që i shesin produktet e tyre në vendet ku nuk krijohen pengesat e mundshme në qarkullim. Përndryshe, nuk po bëj politikë.

Nënkryetari – Po e përmendi edhe njëherë, vendet e caktuara ekzistojnë dhe secili bujk ka të drejtë t’i shes produktet e tyre pa asnjë pengesë.

Burim Krasniqi – Parimisht pajtohem me Defrimin, megjithatë “gjuha është prej tulit” ose mund të themi po bëjmë politikë, ose po shprehim shqetësim! Në procesverbalet e inspektoriatit përshkruhet një prej arsyeve “ekspozimi i mallit”. Malli do të ekspozohet njëjtë edhe në treg brenda. Është fakt që nuk është e mirë të bllokohet trotuari, po duhet të ekzistojë një parim prej Mrasorit deri në Krushe të Madhe, deri në Opterushë e deri në Zatriq, jo diku po e diku jo. Në rastin e Xërxës është e njëjta formë e ekspozimit në prona publike, si granit, tavolina, karriga dhe gjithçka tjetër. Nënkryetar, kërkoj që veprimi të jetë parimor, kur fillohet te i pari, të përfundohet te i fundit me të njëjtin standard.

Nënkryetari – Të gjitha produktet në vendet e caktuara do të vazhdojnë të shiten, pa i penguar askush. Shitja ambulante ku uzurpohen trotuarët është e pakuptimtë. Ekspozimi i mallrave te shitoret dhe te bizneset e caktuara, ata pajisen me një leje nga Drejtoria e Shërbimeve publike një vjeqare, apo mbi bazën e kërkesës për hapësirën përball shitores, objektit apo biznesit. Tek ekspozimi i mallrave në tregje, unë kam qenë edhe në Londër dhe ekspozimi është gjithashtu i njëjtë dhe normal. Në qendër të qytetit, bllokimi i trotuarëve është jashtë

çdo logjike dhe nëse i përkrahim këta, mund ta marrim me mend tutje çka do të ndodh. Gjithmonë jemi në përkrahje për bujqit, por në një formë ligjore më të mirë dhe më të lehtë.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar! A kemi diskutim tjetër?... Nëse jo, atëherë paraprakisht duhet të ju njoftoj që si pika shtesë për mbledhjen e ardhshme të kuvendit do të jenë: Aprovimet e procesverbaleve nga mbledhjet e jashtëzakonshme 12.07.2023 dhe 17.07.2023 dhe pika e dytë shtesë ka të bëjë me vendimin për falje të borxheve mbi tatimin në pronë.

Nënkryetari – Sa për sqarim, kërkohet me ligj që secili kuvend komunal proceduralisht të ketë një vendim për faljen e borxheve që qeveria ka marr vendim. Ligji veçse ka hyrë në fuqi sepse është shpallur në gazetën zyrtare.

Burim Krasniqi – Nënkryetar, meqenëse është obligim ligjor, në çoftëse asambleja nuk e voton faljen e borxheve, çka ndodh?... A do ta ketë barrë komuna, apo institucioni qëndror? Kërkoj që në seancën e radhës të na përcjellni një bazë ligjore për pasojat që i ka kuvendi i komunës në rast se nuk kalon në asamblë komunale!

Nënkryetari – Sa e lexova një paragraf të ligjit, aty thotë që nga momenti i shpalljes në gazetë zyrtare, brenda 30 ditëve kuvendet komunale janë të obliguara që të marrin vendim për falje të borxheve. Sipas meje, vendimi i kuvendit komunal nuk ka afekt juridik, sepse ligji është mbi të gjitha. Si proces kërkohet të merret vendimi, si efekt juridik është nul.

Kryesuesi – Faleminderit! Atëherë e përmbylлим këtë mbledhje dhe shihemi në mbledhje të tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

